A.nr.333/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi- Bajraktari - anëtarë, me Rushit Kajtazi - në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 333/2026 të datës 24.03.2026 të parashtruar nga ankuesi SH.E, kundër organit të punësimit Autoriteti i Konkurrencës në çështjen juridike "*vlerësim i rezultateve në punë* ", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.09.2026 mori këtë;

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 333/2026, e datës 24.03.2026, e parashtruar nga ankuesi SH.E.

II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 25.02.2025, për periudhën nga data 01.08.2025, deri me datën 31.12.2025, të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga " e **Pa pranueshme** ", bëhet "**arrin pritshmëritë".**

III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesin si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.

IV. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës, që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij**.**

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, SH.E (tutje referuar vetëm ankuesi), me datën 24.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 30.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës, ndërsa kjo e fundit me datë 02.04.2026 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejmë referuar:* Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën e parashtruar nga ankuesi drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 1469/2026 të datës 24.03.2026; Formuarin e Vlerësimit tm rezultateve në punë për vitin 2025; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesin; Dëshmi mjekësorë e datës 24.02.2026; Aktakuzë PP.II. Nr. 7334/23, e Prokurorisë Themelore në Prishtinë; Përgjigjen në kërkesë e datës 23.04.2025; Emalin e datës 28.01.206, dërguar nga N.B, për N.O.K.A; shkresa e datës 05.05.2025; Opinion për shqyrtimin e Konfliktit të Interesimit me numër protokolli 1213/2024, i datës 11.09.2024; Vendimi A. nr. 279/2025, i datës 07.04.2025, i Këshillit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.03.2026, dërguar nga R.K, për I.Z; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 333/2026, e datës 02.04.2026; Akt Emërim e datës 02.07.2023, për ankuesin Sh.E; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Inspektor Hetues i Konkurrencës''; Plani Individual i Punës për vitin 2025; Formuarin e Vlerësimit rezultateve në punë i datës 27.02.2026, për vitin 2025, për ankuesin Sh.E; Formuarin e Vlerësimit rezultateve në punë i datës 25.02.2026, për vitin 2025, për ankuesin Sh.E; Vendimi A. nr.1823/2025, i datës 30.03.2026, i Këshillit; Vendimi i datës 03.11.2025; Njoftimi i datës 06.11.2025; Emalin e datës 24.03.2026, dërguar nga Sh.E, për A.T.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, ***sepse.***

Nga administrimi i provave të lëndës, rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Autoritetin e Konkurrencës, sipas Akt Emërimit me numër protokolli 332/25-13/3 të datës 02.07.2023, në pozitën '' Inspektor Hetues i Konkurrencës''. në Autoritetin e Konkurrencës.

Më tej nga shkresat lëndës Kolegji ka gjetur së Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 25.02.2026, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2025, për periudhën nga data 01.08.2025, deri me datën 31.12.2025, lidhur me vlerësimin e përgjithshëm e ka vlerësuar me nivelin "e **papranushme''.**

Kolegji ju referua Ligjit Nr.8/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht Neni 52 paragrafi 1,2,3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 si dhe paragrafit 4,5,6 nën paragrafit 6.1,6.2 dhe paragrafit 11 ku përcaktohet se "Vlerësimi i rezultateve në punë 1. ***Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësive të njësisë***. 2. ***Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues***. 3. ***Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen***; 3.2. ***aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale***; 3.3. ***aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të***

2025/00542

shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4.***Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave***. 5. ***Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil***. 6. ***Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore***. 11. ***Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin***.

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, konkretisht Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 25.02.2026, të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, për ankuesin i cili është vlerësuar në nivelin“ *e papranueshme”*, **dhe se në komentet e mbikëqyrësit ku konstatohet se**; *Bazuar në Sjelljet e tij tejet negativë, aftësitë metodologjike, personale dhe sociale janë në standartë minimale të kërkuara institucionalisht ai nuk zbaton fare metodologji të duhura për organizimin, analizimin dhe monitorimin , nuk respekton ligjin, aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme dhe nuk demonstron aftësi për menaxhim profesional të rasteve. Nga perspektiva personale dhe sociale mungesa e bashkëpunimit tendencat për krijim konflikti, insinuta dhe sabotim të punës së ekipit tregojnë paaftësi, të theksuar në komunikim dhe ndërveprime profesionale, duke cenuar seriozisht funksionimin , disiplinën dhe integritetin e institucionit, Vlerësimi për vitin 2024, ka qenë mjaftueshëm pozitivit të cilin e ka animuar dhe i'u është refuzuar ankesa nga KPMSHCK, edhe pas kësaj z. Elezi, nuk ka treguar gatishmëri për permisim edhe pasi është trajtuar dhe thirrur për trajnim dhe avancim, ka refuzuar pjesëmarrjen duke mos shfrytëzuar mundësitë për rritje profesionale. Si rezultat i këtyre veprimeve dhe mungesës së thellë për reflektim dhe përmasimin e sjelljeve problematike, vlerësimi përfundimtar është negativë, duke mos reflektuar mosrespektimin e ligjit dhe standardet institucionale.*

Tutje, nga Formulari për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, të berë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit i datës 25.02.2026, rezulton se të njëjti e ka vlerësuar me nivelin: **e papranshme",** e që sipas nenit 9 paragrafit 3 nën paragrafit 3.5 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, **e papranshme",** shprehimisht theksohet se: **3.5.**“*E papranueshme" është vlerësim që tregon se nëpunësi civil ka dështuar të përmbushë në mënyrë të dukshme dhe të përsëritur pritshmërinë dhe kërkesat për roline tij. Performanca është shumë poshtë standardeve të përcaktuara dhe kërkohet veprim i menjëhershëm për përmirësim*"..

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesi sa i përket vlerësimeve të rezultateve në punë morri për bazë Vendimin A.Nr. 279/2025, të datës 07.04.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku ne arsyetimin e vendimit të Këshillit eshët konstatuar se pasi sipas Aktakuzë PP.II.nr.7334, të datës 18.03.2024, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ngritur pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti i Përgjithshëm, se S.B Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ku theksohet dyshohet se i nijeti ka kryer vepër penale ‘'*lëndim i lehtë trupor",* nga nenin 185, paragrafi 1, pika 1.4, të KPRK-së, ndaj ankuesit SH.E, po ashtu edhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me datë 04.09.2024, *ka dhënë opinionin ligjor lidhur me konfliktin e interesit ku thuhet se; Rastet kur zyrtari(nëpunësi) duhet përjashtuar nga procedura administrative janë të përcaktuara me nenin 29,30 dhe 31, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe si rrjedhojë është përgjegjësi e zyrtarit por edhe e udhëheqësit të Drejtpërdrejtë dhe e institucionit udhëheqës respektimi i dispozitave përkatëse, në raste se plotësohen kushtet për përjashtim",* andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, sepse Drejtori i Përgjithshëm i

2025/00542

Autoritetit të Konkurences,vlersimin e ka bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse i njëjti konform dispozitave të lartshënuara është dashur të përjashtohet nga vlerësimi sepse është fakt i ditur se të njëjtit kanë mosvarjeshje personale të pa zgjidhura.

Po ashtu sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin SH.E, nga drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, sepse i njëjti nuk ka bërë vlerësimin e punës sipas nenit 5 të LZP Nr.08/L-197, prandaj vlerësimi është berë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 1.5, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: 1.3. *është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;1.5.është në kundërshtim me ligjin material*, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe si i tillë, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin nuk mund të prodhonë efekt juridike, sepse vlerësimi i rezultateve në punë është bërë me shkeljet të ligjit material dhe mbi bazën e kësaj Kolegji vendosi si në diapozitivin e këtij vendimi.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, dhe si rrjedhojë duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht të aprovoj në tërësi ankesën si të bazuar, ankesën e ankuesit të anuloj, Formuarin për Vlerësimin e Rezultateve në për ankuesin SH.E, për vitin 2025 të datës 25.02.2026, ndërsa Vlerësimi vjetor për ankuesin për vitin 2025, konsiderohet në nivelin "**Arrin pritshmërinë**".

Nisur nga konstatimet si me lartë. Kolegji i Këshillit konstaton së organi i punësimit Autoriteti i Konkurrencës, pas pranimit të këtij vendimin është e obliguar që të zbatojë vendimin e Këshillit dhe të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi Ligjit Nr.8/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe Rregulloren Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, në dosjen e ankuesit SH.E, të vendosë Vendimin e Këshillit, që të shërbejnë si fakt dëshmi lidhur me vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin SH.E.

Thënë si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike**: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.333/2026

Rushit Kajtazi — Procesmbajtës

Eshref SHABANI — Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit SH.E;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës; dhe*
- *Arkivit të KPMShCK-së.*

2025/00542